



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1259 Prot.

Tiranë, më datë 03.10.2023

VENDIM
Nr. 507, datë 03.10.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 *“Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”*, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 *“Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”*, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 *“Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”*, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 03.10.2023:

VENDOSI:

1. Shtyrje Vendimmarrje për rishikimin e projektit *“Ndërhyrje restaurimi/mirëmbajtjeje në rreshtin e parë të mureve që kufizojnë Qendrën Mesjetare të qytetit të Beratit (paketë mirëmbajtjeje nr.1 ndërhyrje në mure, porta dhe fasada)”*, Brenda Kufirit Qendër Historike Berat, me aplikues dhe zhvillues **DRTK Berat**, me argumentin:
 - Të plotësohet projekti me versione të tjera të pozicionimit të portës dhe materialit të saj.
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për Trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27/2018 *“Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”*, datë 17.05.2018, neni 72, pika 1 dhe 2;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
4. Ndaj vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Klesta QIRICI

